

**BASHKIA MALLAKASTËR
NJËSIA E PROKURIMIT**

Date me: ____ / ____ / 2025.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës- PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mbrojtje Lumore Gjatësore e Tokave Bujqesore në Fshatin Corrush, Mallakastër”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : 45246400-7 - Punime për parandalim përmbytjesh

VLERA E FONDIT LIMIT: 55,214,284 (pesëdhjetë e pesëmilion e dyqind e katërmëdhjetë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Bazuar në nenin 53, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 67, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kjo procedurë prokurimi zhvillohet nga AK Bashkia Mallakastër.

Për fillimin e kësaj procedure, nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka dalë urdhëri përkatës i prokurimit, nëpërmjet të cilit është ngritur edhe Njësia e Prokurimit. Në vijim, është marrë konfirmimi përkatës nga Dega e Thesarit Mallakastër, si dhe nga Sekori i Financës në Bashki është marrë numri i transaksionit të kërkesës (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, sipas njoftimit të përbashkët të MFE dhe APP dhe Manualit Teknik “Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Mallakastër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1 . KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

***Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenet 26, 29 dhe 30, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenet 26 dhe 41, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 80 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet (jo më e vogël se 80 % e vlerës së fondit limit).

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar më sipër, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Raporti pozitiv ndërmjet aktivit dhe pasivit të balanceve të dy viteve të njëpasnjëshme, konsiderohet tregues i rëndësishëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes së kapaciteteve ekonomike dhe financiare të Operatorëve Ekonomikë ofertues, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter është në përputhje edhe me legjislacionin e fushës, konkretisht, me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe në kërkesat e Ligjit Nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2024 dhe 2025 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësisë të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, e Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përveç bazës ligjore të sipërcituar, ky kriter mbështetet edhe në legjislacionin e fushës, konkretisht, në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe në nenet 2, 4 dhe 40, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij kriteri synohet të vërtetohet që Operatori Ekonomik ofertues, e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me kuadrin rregullator dhe duke përmbushur në mënyrë korrekte detyrimet që burojnë sipas legjislacionit të fushës, pasi të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtar kanë detyrim të regjistrohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për të bërë të identifikueshme vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshkruar pagesës së taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga ky legjislacion.

2.3.Kapaciteti teknik :

2.3.1 Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit;
2. Kontratën/Kontratat;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt Kolaudimi
5. Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore;
6. Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim

-Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë sipermarrje;
2. Leje për kryerje punimesh
3. Situacionin përfundimtar;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore;
5. Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e perhershme të marrjes në dorezim;

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku percaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve si dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatorët Ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP- 1 A Punime gërmimi në tokë.

NP-9 C Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike e bonifikime

NP-12 B Punime të inxhinierisë mjedisore

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licensave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton *"Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane."*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve ne prevenivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore qe do te beje Kontraktori per perfundimin me sukses te punimeve sipas kontrates ne kete objekt jane:

- Mobilizimi
- Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve
- Aktivitetet e Punimeve Ndertimore
- Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut
- Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesise se materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe janë analizuar në tabelën e mëposhtme:

Kategoria e Licenses	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Vlera e punimeve në preventiv, sipas kategorisë përkatëse
NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.	Ne preventivin e punimeve parashikohen punime për Gjurmim dhe me ekskavator goma 0.25 m ³ , në kanale gjeresi deri 2 m, prani uji, kategoria III, me shk në mjet	2,825,090
NP-9 C Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime	I gjithë Objekti konsiston në Mbrojtje Lumore. Ne preventivin e punimeve parashikohen punime për Mbushje me gur kave, Mbushje me zhavor etj	55,214,284
NP-12 B Punime të inxhinierisë mjedisore	<i>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor</i> , dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Vendi ku ndertohet është zonë e mbrojtur dhe duhet bere kujdes i vecante me punimet mjedisore.	55,214,284
NS-18 A Punime topogjeodezike	Zbatuesi i punimeve është i ngarkuar për kryerjen e punimeve për piketimin e Mbrojtjes gjatësore, kanalit të devijimit, si dhe rruges së aksesit Konsiderohet zbatimi i rievimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh. Thëksojmë se Punimet topogjeodezike do të mbështeten në shkallën e plotë të përgatitjes profesionale, në përdorimin e teknologjive	2,825,090

	bashkëkohore për matjet fushore dhe përpunimin kompjuterik të të dhënave, për të plotësuar kërkesat teknike të parashtruara nga projektuesit. Sa i perket klases "A" se kerkuar, theksojme se kjo fushe specifike nuk shprehet ne zera konkret te preventivit, por eshte komplekse dhe gjithëperfshirese ne te gjitha fazat e zbatimit te projektit, nga momenti i marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit deri ne perfundimin e punimeve dhe dorezimin prane AK-se, te sheshit te ndertimit	
--	---	--

2.3.3 Operoret Ekonomike duhet te kene një punësim mesatar të paktën 32 (tridhjetë e dy) personave të siguruar për periudhen Qershor 2025 – Gusht 2025.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit te mesiperm per numerin minimal te punonjesve duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po

t'i referohemi projektit, preventivit, raportit teknik, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojë në Licensën e kompanisë si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Hidroteknik	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Mjedisi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshaider	1 (nje)	Diplome Universitare

-Për stafin e mesiperm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listepagesat e kompanisë së minimalisht për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i dryshuar, si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm në lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar parashikohet se: “Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të

punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyrën e punëve të objektit të prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, të cilët janë të nevojshëm për realizimin e punimeve. Për më tepër duke qenë se këto punime janë të një rëndësie të vecantë dhe në të njëjtën kohë konsistojnë në ndërtimin e një mbrojtje gjatësore lumore për mbrojtjen e gryerjes së tokave dhe permbytjes së tyre vlerësohet e nevojshme që të kerkohen specialist të fushave inxhinierike si: Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik, Inxhinier Ndërtimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mjedis, Inxhinier Gjeodet/Topograf/ Markshaider,

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik **Inxhinier Ndërtimi**, njesia prokurimit ka marre në konsideratë se projekti për ndërtimin e pritës lumore përfshin dhe ndërtimin e një rruge aksese ndaj është e nevojshme Prania e inxhinierit të ndërtimit.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik **Inxhinier Hidroteknik**, Njesia ka marre në konsideratë se projekti dhe preventivi i punimeve parashikon punime për mbrojtje lumore me qëllim realizimin në përputhje me specifikimet teknike të kontratës kerkohet disponimi i një inxhinieri hidroteknik.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik **Inxhinier Mjedis**, Njesia ka marre në konsideratë dhe thekson se referuar Raporti të vlerësimit të ndikimit në mjedis, Oponencës teknike, Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, Zbatuesi i Punimeve është ngarkuar me detyrim të përgjithshme në kujdesin për mjedisin. Metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kerkohet që të ndermerren me regorozitet masa mbrojtëse sa herë që të jete e nevojshme për të minimizuar ose për të ndaluar efektin negativ në mjedis.

Në lidhje me kërkesën e Drejtuesit Teknik **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshaider** Njesia ka merre në konsideratë dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, i gjithë piktetimi do të kryhet nga Sipermarresi.

Në lidhje me kërkesën **Inxhinier Gjeoteknik** është kërkuar pasi **Punimet e mbrojtjes lumore**, përfshirë ndërtimin e argjinaturave, mureve mbajtëse, strukturave disipative, pritës mbrojtëse ose kanalizimeve të devijimit, zhvillohen në zona me rëshqitje të mundshme të terrenit, lëvizje të ujërave,

rreñmuje dhe erozion. Këto zona janë të ekspozuara ndaj fenomeneve natyrore të rrezikshme që lidhen ngushtësisht me stabilitetin e tokës dhe gjeodinamikën e vendit të ndërtimit.

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

-	Teknik Hidroteknik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
-	Teknik Gjeolog	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
-	Teknik Gjeometer/Topograf	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
-	Punetore te thjeshte	8 (tete)	Kontrate pune
-	Shofer	8 (tete)	Leje Drejtimi
-	Manovrator	12 (dymbedhjete)	Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome / Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Qershor 2025 – Gusht 2025.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovraret, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te cilat duhet te dorezohen ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Per stafin mbeshtetës, në lidhje me kualifikimet janë parashikuar nivele si Kontratat individuale te punës, Diplome / Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Deshmi e Aftesise Profesionale (DAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje

ne listepagesat e shoqerise per periudhen Qershor 2025 – Gusht 2025, te cilat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga institucione shtetërore, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

Në përputhje me nenin 69 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 8 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor që të përcaktojë kriteret e kualifikimit dhe burimet profesionale të domosdoshme për realizimin e suksesshëm të një kontrate publike, përfshirë edhe personelin teknik sipas natyrës së objektit të punimeve. Po ashtu profilet e kërkuar dhe numri i tyre, janë kërkuar në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit, duke marrë në konsideratë edhe zërat konkretë të preventivit të zbatimit të punimeve, volumit të tyre, Raportit Teknik dhe Specifikimet Teknike, si dhe mjeteve që duhet të jepen në dispozicion, pasi parashikohen punime të natyrës së punës.

Teknik Hidroteknik Punimet për mbrojtje lumore janë punime hidroteknike në natyrë:

Përfshijnë ndërhyrje në rrjedhje lumore, argjinatura, pritë mbrojtëse, kanale devijimi, shtrime shtrati, mure disipative, etj. Këto punime ndodhin në kontakt të drejtpërdrejtë me rrjedhën dhe kërkojnë njohje teknike të prurjeve ujore, veprimit të ujit mbi strukturat, erozionit dhe sedimentimit. Ligji nr. 111/2012 “Për burimet ujore” parashikon që ndërhyrjet në trupat ujorë dhe mjediset përreth tyre të bëhen me analizë të ndikimit në tokën dhe strukturat gjeonatyrore.

Teknik Gjeolog Shtrati dhe brigjet e lumenjve janë shpesh në zona aluvionale, me shtresa të lëvizshme, të lagështa dhe të paqëndrueshme. Teknik Gjeolog vlerëson rrezikun nga rrëshqitjet, fundosja, çedimi i tokës, apo veprime të ujërave nëntokësore. Ligji nr.111/2012 “Për burimet ujore” parashikon që ndërhyrjet në trupat ujorë dhe mjediset përreth tyre të bëhen me analizë të ndikimit në tokën dhe strukturat gjeonatyrore.

Teknik Gjeometer/Topograf Matjet dhe përgatitja e gjurmës së punimeve

Punimet zhvillohen në ambiente të hapura dhe natyrore, përgjatë lumit ose kanaleve ekzistuese.

Tekniku topograf bën vendosjen e piketave, përcaktimin e nivelit të themelimit, kotes së argjinaturës, mureve mbrojtëse, seksioneve disipative, etj.

Punëtor të thjeshtë Për punimet të ndryshme të cilat do të dalin gjatë zbatimit të kontratës.

Shofer Te nevojshëm për kamionat dhe mjetet e tjera të cilat është e nevojshme që të jenë prezentë shoferet për realizimin e zërave të punës dhe objekt kontratës.

Manovrator Te nevojshëm për mjetet e renda dhe mjetet e tjera të cilat është e nevojshme që të jenë prezentë Manovratorët

për realizimin e zërave të punës dhe objekt kontratës.

Po ashtu, Njësia e Prokurimit thekson se duke marrë në konsideratë mjetet minimale të nevojshme për kryerjen e punimeve është përlogaritur edhe numri i shofereve dhe manovratorëve që duhen.

Sa më sipër me qëllim realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike dhe zbatimin me sukses të kontratës si dhe kontrollin e nevojshëm në të gjithë etapën e punës që kërkohej të realizohet, kërkon minimalisht stafin e kërkuar.

2.3.6 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

2.3.6/a -1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

2.3.6/b -1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.6/c -1 (një) Punonjës I pajisur me certifikatë për “Punime në prani/presence uji”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë akredituara shqiptare ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Qershor 2025 – Gusht 2025.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet

te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Argumentimi: Argumentim Ligjor dhe Teknik për Punime në Prezencë Uji

Në përputhje me **nenin 6 dhe 69 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në bazë të nenit 3 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e Rregullores për Prokurimin Publik”,** autoriteti kontraktor ka të drejtë dhe detyrim të përfshijë në dokumentet standarde të tenderit të gjitha zërat e punimeve që janë të nevojshme për realizimin e plotë dhe të sigurt të objektit të kontratës.

Punimet në **prezencë uji** konsiderohen punime të **detyrueshme ndihmëse ose mbrojtëse**, kur situata gjeologjike, hidrologjike ose kushtet e terrenit tregojnë për mundësinë e pranisë së ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore gjatë realizimit të gërmimeve ose ndërtimeve. Këto punime janë të domosdoshme për të siguruar:

- Stabilitetin e gropave të gërmimit;
- Sigurinë e punonjësve në kantier;
- Mbrojtjen e strukturave ekzistuese;
- Vazhdueshmërinë e punimeve pa ndërprerje ose vonesa për shkak të ujërave.

Sipas **Standardit Teknik Shqiptar (STASH)** dhe praktikave të përfshira në **analizat e punimeve të ndërtimit sipas Institutit të Ndërtimit**, punimet në prezencë uji janë parashikime paraprake në rastet kur:

- Terreni ka prani të ujërave freatike;
- Ka nevojë për devijim, pompim apo izolim të ujit në fazat e gërmimit apo konstruksionit nëntokësor;

- Përfshihen punime drenazhuese ose ndërtim mbrojtjesh provizore.

Gjithashtu, bazuar në **nenin 8 të Ligjit për Prokurimin Publik**, autoriteti kontraktor ka detyrim të sigurojë që specifikimet teknike të jenë të plota dhe të mjaftueshme për të shmangur keqinterpretimet dhe mungesën e qartësisë gjatë fazës së ofertimit.

2.3.7 Operatoret Ekonomike duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësi a	Sasi a
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope	6
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	Në pronësi ose me qira	Cope	2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	Në pronësi ose me qira	Cope	1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 1.5 deri ne 2 ton	Në pronësi ose me qira	Cope	1
5	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	3
6	Eskavator me zinxhir me krahe te gjate mbi 20 m	Në pronësi ose me qira	Cope	1
7	Grejder (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	1
8	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	1
9	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	2
10	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 14 ton	Në pronësi ose me qira	Cope	2
11	Buldozer	Në pronësi ose me qira	Cope	1
12	Koke terheqese	Në pronësi ose me qira	Cope	2
13	Dumper me kapacitet mbajtes mbi 30 ton (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	2
14	Minidumper (mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	1
15	Eskavator me zinxhir me krahe te gjate mbi 15 m	Në pronësi ose me qira	Cope	3
16	Pirun Teleskopik me rrotullim 360° me krahe te gjate mbi 20 m(mjet teknologjik me goma)	Në pronësi ose me qira	Cope	1

17	Pompe uji	Në pronësi ose me qira	Cope	3
18	Tabela Kantier	Në pronësi ose me qira	Cope	5
19	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	Cope	2

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndersa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndersa për mjete të marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave/ Kontrate Bashkëpunimi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qera janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Njesia e prokurimit thekson se mjetet e transportit nevojiten per transportimin e materialeve te ndertimi.

Ndersa mjetet e germimit nevojiten per germimin e themeleve dhe sistemimin e ambienteve gjate punimeve per rikonstruksionin e shkolles.

2.3.8 Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 45001:2015**, mbi “Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe sigurise në punë”, ose ekuivalentin e saj
- **ISO 14001:2015**, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar natyrës se veçantë, vendndodhjes dhe përmasave te objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë sigurise ne pune dhe mjedisit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Nr	Lloji i makinerive	Perdorimi
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes min 20 ton	Nevojitet per transportin e materialeve si gure dhe zhavorr ne kantier
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	Nevojitet per transportin ematerialeve si gure dhe zhavorr ne kantier
3	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 3.5 deri ne 5 ton	Nevojitet per transportin e materialeve si dhe transportin e mjeteve si karroca, pompa uji, Gjeneratore punetore etj
4	Kamioncine me kapacitet mbajtes nga 1.5 deri ne 2 ton	Nevojitet per transportin e materialeve si dhe transportin e mjeteve si karroca, pompa uji, Gjeneratore punetore etj

5	Eskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	Nevojitet per germimin e lumit, referuar dhe zerit ne preventiv
6	Eskavator me zinxhir me krahe te gjate mbi 20 m	Nevojitet per hedhjen e gurit ne lum dhe per gerimin e kanalit te deijimit ne pjeset qe se kap dot eskavatori me goma
7	Grejder (mjet teknologjik me goma)	Nevojitet per nivelimin e rruges
8	Fadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	Nevojitet per hapjen e zhavorrit
9	Minifadrome (mjet teknologjik me goma)	Nevojitet per hapjen e zhavorrit, ne ato vende ku nuk ka akses fadroma
10	Rrul vibrues Gome-Hekur me kapacitet mbi 14 ton	Nevojitet per ngjeshjen e rruges
11	Dumper me kapacitet mbajtes mbi 30 ton (mjet teknologjik me goma)	Nevojitet per transportin e materialit si gur kave apo zhavorr nga vendi i blerjes deri ne kantier.
12	Minidumper (mjet teknologjik me goma)	Nevojitet per te transportuar material zhavorrr apo gur, aty ku nuk ka akses mjetet e renda
13	Eskavator me zinxhir me krahe te gjate mbi 15 m	Nevojitet per hedhjen e gurit ne lum
14	Pirun Teleskopik me rrotullim 360° me krahe te gjate mbi 20 m(mjet teknologjik me goma)	Eshtë një makineri shumë specifike që përdoret në aplikime të rënda ndërtimore, Krahu teleskopik mbi 20 metra lejon vendosjen ose ngritjen e ngarkesave, gjithashtu qendrimin e punetoreve ne kosh per te kryer ndonje proces pune si levizje guri dhe pozicionim efikas.
15	Pompe uji	Per largimin e ujit gjate punimeve
16	Tabela Kantier	Per te sinjalizuar qe ne terren po kryen punime
17	Gjenerator	Per te furnizuar me energji elektrike kantierin per ndricim , energji etj, pasi nuk ka shtylla apo linja tensioni prane

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: